

Memorandum Mirëkuptimi

për krijimin e Rrjetit të OJQ-ve Shqiptare për të mbështetur krijimin dhe menaxhimin e Natyra 2000

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), në bashkëpunim me organizatat “Agri-En”, Librazhd, “Flag Pine”, Vlorë, “Federata e Pyjeve dhe Kullotave Komunale”, Shkodër dhe me mbështetjen e Programit Green-AL¹, në kuadër të projektit “Fuqizimi i OJQ-ve Shqiptare për të mbështetur krijimin dhe menaxhimin e rrjetit Natyra 2000 në Shqipëri / Mbrojtja e Biodiversitetit”, kanë vullnetin të krijojnë Rrjetin e OJQ-ve Shqiptare për NATURA 2000 (Rrjeti).

INCA dhe organizata Flag Pine, AGRI-EN, FPKK ftojnë OJQ-të shqiptare të bëhen anëtarë të këtij Rrjeti.

Neni I

OBJEKTIVAT E RRJETIT

Objektivat e Rrjetit janë:

- a) Të mbështesë, në bashkëpunim me aktorë të tjerë të ruajtjes, punën për përcaktimin e zonave në Shqipëri brenda rrjetit ekologjik Natyra 2000
- b) Të mbështesë ruajtjen e biodiversitetit si një mjet për të nxitur zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe shkencor të komuniteteve lokale

Neni II

ANËTARËSIMI

- Anëtarët e Rrjetit janë organizata joqeveritare, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, aktive në fushën e biodiversitetit dhe ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

¹ Green-AL është një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA) me fondet e Qeverisë Suedeze, si një vijimësi e mbështetjes së Qeverisë Suedeze në fuqizimin e sektorit mjedisor dhe angazhimit civil.

- Anëtarët e Rrjetit veprojnë në baza vullnetare.
- Anëtarët e Rrjetit respektojnë diversitetet fetare, gjinore, etnike dhe të tjera; ato veprojnë në përputhje me tolerancën dhe parimet jodiskriminuese.
- Anëtarët e Rrjetit veprojnë si një entitet i vetëm në publik, në përputhje me objektivat e Rrjetit.
- Rrjeti merr vendime me shumicë votash në votim publik, me praninë e shumicës së anëtarëve të tij.

Neni III

SEKRETARIATI I RRJETIT

Sekretariati i Rrjetit ndodhet në ambientet e INCA-s, Rruga Islam Alla, Pall. IVEA, Kati I, Tiranë.

Neni IV

TË DREJTAT E ANËTARËVE TË RRJETIT

Të drejtat e çdo anëtari janë:

- Të zhvillojë dhe zbatojë ide të reja projektesh në përputhje me objektivat e Rrjetit dhe
- Të jetë i informuar me kohë dhe rregullisht për punën dhe planet e Rrjetit.

Neni V

DETYRIMET E ANËTARËVE TË RRJETIT

Detyrimet e çdo Anëtari janë:

- Të ndjekë objektivat e Rrjetit dhe të punojë për zbatimin e vendimeve të tij
- Të kujdeset për reputacionin e Rrjetit kur drejton aktivitetet e veta, dhe
- Të veprojë në mënyrë profesionale gjatë drejtimit të aktiviteteve në emër të Rrjetit.

Neni VI

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SEKRETARIATIT

Të drejtat dhe detyrimet e Sekretariatit janë:

- Të sigurohet komunikim i rregullt i Anëtarëve të Rrjetit

- Të sigurojë takime të rregullta të anëtarëve të Rrjetit
- Të propozojë ide të reja projektesh në përputhje me objektivat e Rrjetit dhe
- Të informojë për ngjarjet përkatëse në vend dhe në rajon për të siguruar shkëmbim efektiv të të dhënave/informacioneve për Natyra 2000.

Neni VII

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Rregullat dhe procedurat e Rrjetit do të bien dakord dhe do të shtohen në këtë dokument si Aneksi 1.

Neni VIII

PËRFUNDIMI I ANËTARËSISË

Anëtarësimi ndërpritet nëse:

- një Anëtar vendos kështu
- aktivitetet e një anëtari bien ndesh me objektivat e Rrjetit.